



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUALE

PA1 Nr.08-140

25.04.2025

Shkup

Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 1 dhe nenit 20, paragrafi (1), nënparagrafi 10¹ të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe AAudiovizuale ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 69, paragrafët (1) dhe (4), nenin 70, paragrafët 1, 4, 6, 9, 10, 11 dhe 12, nenin 71, nenin 74, nenin 79, nenin 80 dhe nenin 81 nga Ligji i njëjtë, nenin 15, paragrafi (1), nënparagrafi 1, nenin 39, paragrafi (1), nënparagrafi 10 dhe nenin 51, paragrafi (1) të rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe AAudiovizuale (Tekst i konsoliduar) nr. ark. 01-3732/1 datë 29.07.2019, dhe në lidhje me Letrën me qëllim të dhënies së lejes për transmetim në radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Prilepit nga pala e interesuar, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive BUBA MARA Ranko SHPKNJP Shkup (nr. ark. 08-5084/1 datë 11.12.2024), me shtesa (nr. ark.08-102/1, datë 10.1.2025), Njoftimin nga Agjencia e Komunikimeve Elektronike, nr. ark. 0805-87/4, datë 5.2.2025 (nr. ynë ark. 08-102/3, datë 13.2.2025), Studimin për përcaktimin e arsytimit për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Prilepit (nr. ark. 03-1705/1, datë 10.4.2025) dhe Konkluzionin nr. ark. 02-1832/3, datë 24.4.2025., në seancën e 18-të mbajtur më 24.4.2025, miratoi si vijon:

VENDIM

**për shpallje të konkursit publik për dhënie të
lejes për transmetim në radio të shërbimit programor
në nivel lokal**

1. Shpallet konkursi publik për dhënien e 1 (një) leje për transmetim në radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Prilepit, për shërbimin programor radio muzikore me format të specializuar, deri në 5% përmbajtje folëse, në gjuhën maqedonase dhe serbe, në të cilën muzika e transmetuar është kryesisht argëtuese, dhe do të transmetohet përmes radiofrekuencës së përcaktuar nga Agjencia e Komunikimeve Elektronike (AKE), përkatësisht: 90.3 MHz.

2. Leja do të ndahet për periudhë kohore prej 9 (nëntë) vjetësh dhe nuk mund t'i bartet personi tjetër.

3. Kandidatët në konkurs duhet të përmbushin kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike, të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio (Tekst i konsoliduar) nr. ark. 01-3953/1 datë 31.10.2023, që janë shpjeguar dhe specifikuar në dokumentacionin e konkursit.

4. Karakteristikat teknike dhe parametrat e përcaktuara nga AKE në pajtim me Ligjin për Komunikime Elektronike ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 39/14, 188/14, 44/15, 193/15, 11/18 dhe 21/18 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr. 98/19, 153/19, 92/21, 222/24 dhe 59/25) dhe rregulloret e miratuara në

¹ Nënparagrafët 8 dhe 9 janë fshirë, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 248/18).

bazë të ligjit, janë shpjeguar dhe specifikuar në dokumentacionin e konkursit dhe miratimin për përdorimin e radiofrekuencave të dhëna nga AKE.

5. Aplikimet e paraqitura për konkurs, Agjencia e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) do të vlerësohen në bazë të kriterëve në vijim, sipas mënyrës së mëposhtme të pikëzimit:

1. Përfaqësimi i programit të prodhuar nga vetë transmetuesi (in-house production), gjatë javës		17 pikë
• deri në 50% të pjesës folëse të programit	10 pikë	
• mbi 50% të pjesës folëse të programit	17 pikë	
2. Cilsia, zhanri dhe diversiteti tematik i përmbajtjeve		17 pikë
• nga 2 deri në 4 lloje programesh në pjesën folëse të programit	10 pikë	
• mbi 4 lloje programesh në pjesën folëse të programit	17 pikë	
3. Përfaqësimi i programeve që nxisin zhvillimin dhe ruajtjen e kulturës kombëtare		17 pikë
• programe që nxisin zhvillimin dhe ruajtjen e kulturës kombëtare, të transmetuara çdo vit		
• deri në 10 orë gjatë gjithë vitit	5 pikë	
• mbi 10 orë gjatë gjithë vitit	9 pikë	
• muzikë instrumentale nga autorë maqedonas dhe muzikë vokale dhe/ose muzikë vokale-instrumentale në gjuhën maqedonase dhe serbe të transmetuar gjatë gjithë ditës		
• deri më 30% në total të transmetimit muzikor	5 pikë	
• mbi 30% në total të transmetimit muzikor	8 pikë	
4. Përfaqësimi i informacioneve dhe i përmbajtjeve në pjesën folëse të programit me rëndësi për zonën, në të cilën do të transmetohet shërbimi programor (informacion me karakter lokal), gjatë javës		10 pikë
• nga 1 deri në 3 orë të pjesës folëse të programit	5 pikë	
• mbi 3 orë të pjesës folëse të programit	10 pikë	
5. Numri dhe struktura e punonjësve të nevojshëm për kryerjen e veprimtarisë (së paku 2 (dy) persona pjesëmarrës në krijimin e programit, të punësuar në marrëdhënie të rregullt pune me orar të plotë)		7 pikë
• 2 punonjës	5 pikë	
• mbi 2 punonjës	7 pikë	

6. Kushtet teknike për prodhimin e programit		7 pikë
7. Koha e ofruar e programit të transmetuar ditor		7 pikë
• nga ora 10 deri në ora 17	4 pikë	
• mbi 17 orë	7 pikë	
8. Kushtet hapësinore për kryerjen e veprimtarisë		7 pikë
9. garancitë e ofruara për aftësinë financiare për kryerjen e veprimtarisë		7 pikë
10. Afati i propozuar për fillim me kryerjen e veprimtarisë		4 pikë
• deri në 3 muaj nga dita e dhënies së lejes	4 pikë	
• mbi 3 muaj nga dita e dhënies së lejes	2 pikë	
Në tërësi		100 pikë

6. për lejen e transmetimit në radio paguhet kompensim vjetor për çdo vit aktual, duke filluar nga data e dhënies së lejes, në llogari të Agjencisë, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia.

Mënyra e llogaritjes, faturimit dhe pagesës së kompensimit të lejes përcaktohen nga Agjencia në pajtim me nenin 80 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV) dhe në pajtim me Rregulloren për procedurat e punës financiare dhe kontabilitetit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 185/14), Rregulloren për format e shërbimeve programore të transmetuesve ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr.172/14) dhe Rregulloren për zonat e transmetimit të shërbimeve televizive dhe në radio ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 172/14).

7. Për përdorimin e radiofrekuencave paguhet kompensim vjetor në pajtim me Ligjin për Komunikime Elektronike dhe Rregulloren për mënyrën e llogaritjes së kompensimit vjetor për përdorimin e radiofrekuencave të AKE ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 192/21 dhe "Gazeta Zartare e RMV-së" nr. 192/24).

Kompensimi për përdorimin e radiofrekuencave paguhet në llogari të AKE për çdo vit aktual paraprakisht duke filluar nga data e vlefshmërisë së pajtimit për përdorimin e radiofrekuencave.

8. Për përcaktimin e frekuencës së transmetuesit, mikrolokacionit, fuqisë maksimale efektive të rrezatimit (ERP), drejtimit të sistemit të antenës, si dhe për parametra të tjerë teknikë që nuk përcaktohen me këtë Vendim dhe për dokumentacionin e konkursit, kandidatët janë të detyruar (pas tërheqjes së dokumentacionit nga Agjencia dhe marrjes së vërtetimit nga Agjencia për dokumentacionin e tërhequr) të drejtohen në AKE, ku do të marrin parametrat teknikë të detajuar, që janë pjesë përbërëse e dokumentacionit të konkursit dhe sipas të cilit do të duhet të përgatitet raporti teknik për pjesën e transmetimit.

Paraqitja e kandidatëve në AKE duhet të jetë me të njëjtin emër si në Agjenci.

9. Kandidatët e konkursit paraqesin aplikime në formular të veçantë, formën dhe përmbajtjen e të cilit e përcakton Agjencia, dhe publikohet në ueb faqen e Agjencisë.

Dokumentacioni i konkursit dhe formulari – Aplikacioni për pjesëmarrje në konkurs publik për dhënie e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Prilepit, mund të merren në arkivin e Agjencisë, Pallati "Panko Brashnarov", rr. "Makedonija" nr. 38, Shkup, çdo ditë pune nga ora 8:00 deri në ora 16:00.

Për dokumentacionin paguhet kompensim vjetor në shumë prej 60.000,00 (gjashtëdhjetë mijë) denarë në xhirollogarinë: 300000000618023 të Agjencisë, Banka depozituese: Banka Komerciale SHA Shkup.

10. Aplikacioni dorëzohet në zarf të mbyllur në Agjencion, Pallati "Panko Brashnarov", rr. "Makedonija" nr. 38, Shkup, shënuar si vijon², përkatësisht:

- në këndin e sipërm majtas të zarfit të mbyllur duhet të shënohet "MOS E HAP",
- në mes të zarfit të mbyllur duhet të shënohet „Aplikim për pjesëmarrje në konkurs publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Prilepit.

Formularët dhe bashkëngjitjet në Aplikacion për pjesëmarrje në konkurs publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Prilepit, duhet të sistemohen sipas radhës dhe numrit rendor të formularit, përkatësisht bashkëngjitjes së aplikacionit, ku për çdo bashkëngjitje të aplikacionit, në faqen e parë në këndin e sipërm djathtas të fletës të shënohet numri rendor përkatës (Për shembull: bashkëngjitje nr. ____).

Aplikacioni, me dokumentacionin shoqëruar nga neni 73 paragrafi (3) të LSHMAAV, dorëzohet në 2 (dy) kopje (origjinale dhe kopje).

11. Aplikacioni mund të dorëzohet me postë rekomanduese ose me dorëzim në arkivin e Agjencisë.

12. Aplikacioni dorëzohet në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh.

Afati për dorëzimin e aplikacioneve fillon nga dita e pare pas publikimit të këtij Vendimi në "Gazetën Zyrtare të RMV-së".

Aplikimet dorëzohen në afatin e përcaktuar me këtë Vendim në mënyrën, formën, numrin e kopjeve dhe përmbajtjeve të parashikuara në dokumentacionin e konkursit.

Aplikimet e kandidatëve që nuk do të paguajnë kompensimin për dokumentacionin, të cilat do të dorëzohen pas përfundimit të afatit të përcaktuar me këtë Vendim, aplikimet e pakompletuara (që nuk do t'i përmbajnë të gjitha dokumentet dhe bashkëngjitjet në pajtim me Aplikacionin), aplikimet e plotësuara në mënyrë të parregullt, si dhe aplikimet që nuk do të dorëzohen në 2 (dy) kopje (origjinale dhe kopje), nuk do të shqyrtohen.

Informacione shitesë, në lidhje me konkursin publik të shpallur, mund të merren nga personat e mëposhtëm:

- për konceptin programor: mr. Ognen Nedelkovski telefon celular: 072/212-686 dhe e-mail adresa: o.nedelkovski@avmu.mk; Rubin Talevski telefon celular: 075/452-523 dhe e-mail adresa: r.taleski@avmu.mk;

- për strukturën pronësore dhe kushtet kadrovike: Katerina Donevska telefon celular: 075/452-543 dhe e-mail adresa: k.mitre@avmu.mk;

- për kushtet teknike dhe hapësinore: mr. Arben Saiti telefon celular: 076/203-222 dhe e-mail adresa: arben.saiti@avmu.mk;

- për kushtet financiare: Goran Radunoviq telefon celular: 071/223-219 dhe e-mail adresa: g.radunovic@avmu.mk; Vesna Simonovska telefon celular: 076/344-198 dhe e-mail adresa: v.simonovska@avmu.mk и

- për informacione të përgjithshme dhe çështje juridike: mr. Ivona Mufisheva telefon celular: 076/496-803 dhe e-mail adresa: i.mufiseva@avmu.mk dhe mr. Tanja Lazoroska telefon celular: 075/452-528 dhe e-mail adresa: t.lazoroska@avmu.mk

13. aplikacionet që do të dorëzohen në këtë konkurs publik, do të hapen publikisht, në selinë e Agjencisë, Pallati "Panko Brashnarov", rr. "Makedonija" nr. 38, Shkup, një javë pas përfundimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve, përcaktuar në pikën 12 të këtij vendimi.

Informacionin për ditën dhe orën e hapjes publike do të publikohet në ueb faqen e Agjencisë: www.avmu.mk.

14. vendimi për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Prilepit, do të merret në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e hapjes publike të aplikacioneve, përcaktuar në pikën 13 të këtij vendimi.

Kandidatët e konkursit do të njoftohen për vendimin për dhënien e lejes, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e miratimit.

² Nëse parashtruesit e aplikimeve për pjesëmarrje në konkursin publik nuk i përmbahen kushteve të përcaktuara në pikën 10. Të këtij Vendimi, Agjencia nuk mban përgjegjësi për vonesën ose hapjen e parakohshme të Aplikimit.

15. Ky vendim botohet në Gazetën Zyrtare të RMV-së, në ueb faqen e Agjencisë dhe së paku në 2 (dy) gazeta ditore, prej të cilave njëra gazetë ditore është në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve të RMV-së, dhe hyn në fuqi nga dita e botimit në Gazetën Zyrtare të RMV-së.

Ar sy e t i m

Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) më 11.12.2024, u dorëzua Letër qëllimi, nr. ynë ark.08-5084/1, datë 11.12.2024 nga pala e interesuar, shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) BUBA MARA Ranko SHPKNJP Shkup, për dhënien e lejes për hapjen e radios lokale në zonën e komunës së Prilepit.

Në lidhje me dorëzimin e Letër qëllimi, Agjencia më 18.12.2024, drejtuar SHTR BUBA MARA Ranko SHPKNJP Shkup, dërgoi Shkresë – Kërkesë për plotësimin e Kërkesës për miratimin e lejes për hapjen e radio stacioni lokal në zonën e Prilepit (nr. ark. 08-5084/2), me qëllim që pala e interesuar të dorëzojë të dhënat për: strukturën e muzikës që planifikojnë të transmetohet dhe gjuhë, në të cilën do të transmetohet pjesa folëse dhe muzikore e programit. Shkresa është pranuar në mënyrë të rregullt nga pala e interesuar më 23.12.2024.

Me datë 10.1.2025, drejtuar Agjencisë nga SHTR BUBA MARA Ranko SHPKNJP Shkup u dorëzua Shtesë të Letrës për qëllime, nr. ark.08-102/1 datë 10.01.2025, ku nga ana e parashtruesit, është sqaruar se duan të konkurrojnë përradioo muzikore me format të specializuara, deri në 5% përmbajtje folëse, në gjuhën maqedonase dhe serbe dhe planifikojnë të transmetojnë muzikë popullore (argëtuese).

Agjencia, në pajtim me nenin 70, paragrafi (4) të LSHMAAV, dhe me rastin e lëndës Letër qëllimi, me një shtesë, me Shkresë – Kërkesë, nr. ynë ark.08-102/2, datë 14.1.2025 iu drejtua AKE ku është kërkuar informacion nëse ka frekuenca të lira në zonën e qytetit të Prilepit, dhe nëse ka – edhe informacion për parametrat bazë teknike në bazë të të cilave do të përpilohet zgjidhje teknike për transmetim të programit në radio.

Me datë 13.2.2025, AKE drejtuar Agjencisë dorëzoi Njoftim në lidhje me kërkesën për informacion për frekuenca të lira për transmetim të programit në radio në nivel lokal për qytetin e Prilepit, nr. ark. 0805-87/4, datë 5.2.2025 (nr. ynë ark. 08-102/3, datë 13.2.2025), se në bazë të alokimeve ekzistuese, analizave të përhapjes dhe matjeve në zonë e qytetit të Prilepit, parametrat bazë teknike sipas të cilave duhet të përpilohet zgjidhje teknike për mbulimin e qytetit të Prilepit janë si në vijim: Lokacioni i transmetuesit: Topolçani/Toptash, Efektiviteti i fuqisë rrezatuese: 300 W dhe Frekuenca: 90.3 MHz.

Neni 70, paragrafi (4) të LSHMAAV përcakton se nëse në pajtim me Planin për ndarjen dhe përdorimin e radiofrekuencave, përcaktohet se ka radiofrekuenca të lira, Agjencia do të përgatisë një studim që do të përcaktojë arsyetimin për shpallje të konkursit publik, veçanërisht nga aspekti i përmbushjes së qëllimit të ligjit, si dhe nga aspekti i nevojave të publikut.

Rrjedhimisht, Agjencia ka përgatitur një Studim për përcaktimin e arsytimit për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Prilepit (nr. ark. 03-1705/1, datë 10.4.2025), i cili është publikuar në ueb faqen e Agjencisë më 10.04.2025.³ Studimi konkludoi si në vijim: “Komuna e Prilepit ka potencial të konsiderueshëm tregu si nga aspekti i publikut potencial ashtu edhe nga reklamuesit potencial (vetëm tre komuna - Kumanova, Manastiri dhe Tetova kanë numër më të madh të banorëve dhe subjekte afariste më aktive). Megjithatë, analiza krahasuese e të dhënave për performancën ekonomike të radiostacioneve nga zonat e tjera lokale, me të dhënat e dy radiostacioneve të Prilepit (RA Meff dhe RA Holidej), tregon se në komunat me potencial më të vogël tregu se në Prilep, radiostacionet lokale arrijnë të ardhura më të larta se këto dy radiostacione, që tregon se potenciali i tregut nuk është shfrytëzuar në mënyrë optimale. Dy radiostacionet e Prilepit transmetojnë shërbime programore radio muzikore-folëse me format të përgjithshëm, dhe nga gjithsej 266 orë muzikë që transmetojnë gjatë një jave, 184 orë janë muzikë popullore, dhe zhanri muzikor më i përfaqësuar është muzika popullore argëtuese (me kohëzgjatje në total prej 127 orë dhe 24 minuta gjatë një jave). Kërkesa e paraqitur i referohet për shërbim programor të specializuar, radio muzikore që do të transmetojë muzikë argëtuese, që do të thotë se publiku do të ketë diversitet më të madh. Hulumtimet e këtij Studimi treguan se ekziston arsyetim për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio në nivel lokal në zonën e komunës së Prilepit, për shërbim programorradio muzikore me format të specializuar, në të cilin muzika e transmetuar është kryesisht argëtuese. Shërbimi programor duhet të transmetohet në gjuhën maqedonase dhe serbe.”

Rrjedhimisht, gjithçka eu shpjegua më lart, dhe duke pasur parasysh se në pajtim me Planin për ndarjen dhe shfrytëzimin e radiofrekuencave, është përcaktuar se ekziston radio frekuencë e lire për

³<https://avmu.mk/istrazuvanja-studii-kon-za-dozvoli-ra-%d1%81%d1%82%d1%83%d0%b4%d0%b8%d1%98%d0%b0-%d0%b7%d0%b0-%d1%83%d1%82%d0%b2%d1%80%d0%b4%d1%83%d0%b2%d0%b0%d1%9a%d0%b5-%d0%bd%d0%b0-%d0%be%d0%bf%d1%80%d0%b0/>

komunën e Prilepit, dhe në pajtim me Studimin, nr. ark. 03-1705/1, datë 10.4.2025, është konstatuar arsyetimi për shpëllje të konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio në nivel lokal në zonën e Komunës së Prilepit, për shërbim programor radio muzikore me format të specializuar, deri në 5% përmbajtje folëse, në gjuhën maqedonase dhe serbe, në të cilën muzika e transmetuar është kryesisht argëtuese, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 1 dhe nenit 20, paragrafi (1), nënparagrafi 10 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 69, paragrafët (1) dhe (4), nenin 70, paragrafët 1, 4, 6, 9, 10, 11 dhe 12, nenin 71, nenin 74, nenin 79, nenin 80 dhe nenin 81 nga Ligji i njëjtë, nenin 15, paragrafi (1), nënparagrafi 1, nenin 39, paragrafi (1), nënparagrafi 10 dhe nenin 51, paragrafi (1) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Konkluzionin nr. ark. 02-1832/3, datë 24.4.2024, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale në seancën e 18-të mbajtur më 24.04.2025, miratoi Vendim sin ë dispozitiv, që do të botohet në Gazetën Zyrtare të RMV-së, në ueb faqen e Agjencisë, si dhe së paku në 2 (dy) gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve të RMV-së, dhe hyn në fuqi nga dita e botimit në Gazetën Zyrtare të RMV-së.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Llazo PETRUSHEVSKI d.v.**